

Katekizmi i Krishterë - Mitropolia e Elbasanit, Shpatit dhe Librazhdit: Kampi Kryezjarrth 2019



Në fshatin e Kryezjarrthit prej datës 10-14 Gusht u zhvillua kampi ditor veror. Kampi u drejtua nga katekistët e Mitropolisë së Elbasanit ndihmuar dhe nga disa prej të rinjve të grupit të katekizmit Kryezjarrth.

Cdo ditë e kampit ishte një gëzim ku dita niste me lutje dhe më pas vazhdonte me këngë të krishtera, mësimë dhe lojëra.

Një pjesë e rëndësishme e kampit ishte dhe përgatitja e një programi festiv nga fëmijët.

Një ditë gjatë kampit zhvilluam një aktivitet ndryshe ku sëbashku të gjithë morëm pjesë për Liturgji Hyjnore pranë Kishës së Shën Nikollës dhe pas shërbesës shkua tek parku I lojrave në ambjentet e kompleksit Kriva ku zhvilluam lojëra të ndryshme

dhe kaluam kohë sëbashku.

Ditën e fundit drekuam së bashku të gjithë prindër dhe fëmijë ku vetë fëmijët kishin përgatitur një aktivitet festiv me këngë, valle, vjersha. Dukej qartë gëzimi në sytë e fëmijëve.

Falenderim shkon për Kryepiskopin Anastas, Motropolitin tonë Andonin, organizatën Word Vision dhe stafin e katekistëve dhe vullnetarëve që bënë të mundur organizimin e këtij kampi.

Lavdi Perëndisë për të gjitha!